

Përmbledhje

Pengesat e vazhdueshme në furnizim si dhe vala e re e infektiveve ndikoi që aktiviteti ekonomik në Eurozonë të shënoj rritje të ngadalësuar prej 3.7 përqind në TM3 2021. Megjithatë, në shtator 2021, BQE rishikoi projeksionet për rritje ekonomike në 5.0 përqind për vitin 2021, nga 4.6 përqind sa ishte projeksioni në qershor 2021. Vendet e rajonit shënuan rritje të lartë të aktivitetit ekonomik në TM3 2021 me një mesatare prej 11.6 përqind, ndërsa parashikimet e FMN-së për vitin 2021 sugjerojnë rritje të aktivitetit ekonomik prej 5.3 përqind për vendet e rajonit.

Ekonomia e Kosovës vlerësohet se ka rikuperuar aktivitetin ekonomik në vitin 2021 si rezultat i lehtësimit të masave kufizuese. Sipas vlerësimeve të ASK-së, BPV-ja reale ka shënuar rritje prej 12.1 përqind deri në shtator të vitit 2021, ku vetëm në TM3 2021, është shënuar rritje prej 14.5 përqind. Rritja e aktivitetit ekonomik vlerësohet se ka vazhduar edhe në TM4 2021, duke u mbështetur në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, rritjen e remitencave, IHD-ve, etj.

Çmimet e konsumit kanë shënuar rritje të lartë prej 4.3 përqind në TM3 2021, nxitur kryesisht nga faktorë të përkohshëm të brendshëm dhe jashtëm që i atribuohen efektit të rimëkëmbjes nga kriza pandemike. Rritja e aktivitetit ekonomik në periudhën raportuese është shoqëruar me përmirësimin e performancës së të hyrave buxhetore. Të hyrat buxhetore në TM3 2021 shënuan rritje prej 38.2 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore shënuan rënie prej 8.3 përqind, duke bërë që buxheti i Kosovës të regjistrojë suficit primar prej 132.5 milionë euro. Borxhi publik ka vazhduar me rritje dyshifrore

vjetore prej 23.4 përqind dhe ka arritur vlerën prej 1.66 miliardë euro, përderisa si përqindje e BPV-së, ka arritur në 23.0 përqind në TM3 2021.

Në sektorin e jashtëm të ekonomisë, llogaria rrjedhëse ka shënuar bilanc pozitiv prej 148.3 milionë euro në TM3 2021, si rezultat i rritjes së bilancit pozitiv të shërbimeve dhe të ardhurave dytësore, ndërkohë që bilanci i mallrave dhe i të ardhurave parësore është përkeqësuar. Bilanci i shërbimeve arriti vlerën prej 668.0 milionë euro nga 146.5 milionë euro në TM3 2020, ndërsa deficitin tregtar i mallrave arriti nivelin prej 1.1 miliardë euro - një rritje për 45.2 përqind krahasuar me TM3 2020. Eksporti i mallrave ka shënuar rritje për 65.7 përqind ndërsa importi i mallrave është rritur për 48.0 përqind. Në kuadër të bilancit të pagesave, rritje të konsiderueshme në TM3 2021 kanë shënuar edhe remitencat (17.1 përqind) dhe IHD-të (106.1 përqind).

Sistemi financiar gjatë kësaj periudhe u zgjerua me ritëm të përshpejtuar si rrjedhojë e ecurisë pozitive të sektorit bankar dhe pensional. Kontributi pozitiv i sektorëve tjerë në këtë rritje ishte i limituar për shkak të peshës së ulët në gjithsej asetet e sistemit financiar. Asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 8.6 miliardë euro në TM3 2021. Në sektorin bankar, aktiviteti u mbështet nga rritja e kreditimit dhe depozitave, përderisa rritja e shënuar në sektorin pensional i'u atribuua kthimit të konsiderueshëm pozitiv në investime dhe kontributeve të arkëtuara nga kontribut-dhënësit.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	1
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	5
Ekonomia e Kosovës -----	7
Spektori Real -----	7
Çmimet -----	7
Spektori Fiskal -----	8
Spektori i Jashtëm -----	9
Sistemi Financiar -----	12
Spektori Bankar -----	13
Bilanci i gjendjes – Asetet -----	13
Performanca e sektorit bankar -----	18
Spektori pensional -----	22
Spektori i sigurimeve -----	24
Performanca e sektorit të sigurimeve -----	25
Spektori mikrofinanciar -----	25
Asetet -----	26
Performanca e sektorit mikrofinanciar -----	28
Tregu i letrave me vlerë -----	29

GRAFIKËT DHE TABELAT

Grafik 1. Norma e rritjes së BPV-së dhe inflacionit në Eurozonë	06
Grafik 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuuesit kryesorë	07
Grafik 3. Inflacioni i përgjithshëm	08
Grafik 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj	09
Grafik 5. Eksporti dhe importi i mallrave	10
Grafik 6. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave	10
Grafik 7. Kategoritë kryesore të importit të mallrave	11
Grafik 8. Remitencat	12
Grafik 9. Struktura e investimeve të huaja direkte	12
Grafik 10. Vlera e asetëve e sistemit financiar të Kosovës	12
Grafik 11. Koncentrimi në asetet e sistemit financiar	13
Grafik 12. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar	13
Grafik 13. Stoku i gjithsej kredive	14
Grafik 14. Kreditë e reja	14
Grafik 15. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo financiare	15
Grafik 16. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare	15
Grafik 17. Bilanci i gjendjes i sektorit bankar	15
Grafik 18. Stoku i gjithsej depozitave	16
Grafik 19. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave	16
Grafik 20. Depozitat e reja	16
Grafik 21. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore	17
Grafik 22. Norma e interesit në kredi deh depozita	17
Grafik 23. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare	18
Grafik 24. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare	18
Grafik 25. Norma e interesit për depozita	18
Grafik 26. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar	19
Grafik 27. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione	19
Grafik 28. Treguesit e solvencës	19
Grafik 29. Treguesit e likuiditetit	20
Grafik 30. Asetet e sektorit pensional	22
Grafik 31. Struktura e asetëve të FKPK-së	23
Grafik 32. Struktura e asetëve të FSKP-së	23
Grafik 33. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së	24
Grafik 34. Asetet e sektorit të sigurimeve	25
Grafik 35. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara	25
Grafik 36. Asetet e sektorit mikrofinanciar	26
Grafik 37. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare	26
Grafik 38. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë	27

Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike
Nr. 36, Tremujori III/2021


Grafik 39. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	27
Grafik 40. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	27
Grafik 41. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik -----	28
Grafik 42. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar-----	28
Grafik 43. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	29
Grafik 44. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore-----	29
Grafik 45. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar -----	29
Grafik 46. Shuma e ofruar dhe e emetuar -----	30
Grafik 47. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	30
Tabela 1. Kontributi i kategorive specifike dhe gjithsej inflacionin -----	08
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	32

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
MF	Ministria e Financave dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e eurozonës u karakterizua me rimbëkëmbje të aktivitetit, megjithë pasiguritë ende të larta rreth dinamikave pandemike dhe pengesave shoqëruese të krizës shëndetësore. Zbutja e masave të kontrollit, pakot stimuluese fiskale si dhe përmirësimi i kërkesës së jashtme u reflektuan në rritje vjetore prej 14.2 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2021. Vlerësimet për rritjen e aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë janë ulur pak për shkak të pengesave të vazhdueshme në furnizim si dhe valës së re të infektiveve me variantin e ashtuquajtur ‘Delta’ të koronavirusit, faktor që u reflektuan në rritje më të ngadalësuar ekonomike prej 3.7 përqind (grafik 1). Për vitin 2021, projekcioni i BQE-së për rritjen reale të BPV-së është rishikuar me 0.4 pikë përqindje, nga 4.6 përqind sa ishte në qershor 2021 në 5.0 përqind në shtator 2021.



Burimi: Eurostat.

Norma mesatare e inflacionit në TM3 2021 ishte 2.9 përqind. Rritja e çmimeve në Eurozonë, përveç rritjes së kërkesës, i'u atribuua edhe faktorëve të përkohshëm të ndërlidhur me pandeminë, siç është rritja e kostos së inputeve si pasojë e ndërprerjes së furnizimit si dhe rritjes së kostove të energjisë. Duke marr parasysh

vlerësimet aktuale për dinamikat dhe perspektivën e inflacionit, që unanimisht po konsiderohen nga bankat qendrore të jenë me karakter të përkohshëm, Këshilli Drejtues i BQE-së vendosi të mbajë të pandryshuar politikën monetare, përderisa kushtet e favorshme të financimit të mbahen me një ritëm më të ulët të blerjeve të aseteve në kuadër të Programit Pandemik të Blerjes së Aseteve krahasuar me dy tremujorët paraprak. Për vitin 2021, BQE ka parashikuar normë mesatare të inflacionit prej 2.2 përqind, normë që pritet të normalizohet në dy vitet vijuese në 1.7 përkatësisht 1.5 përqind në 2022 dhe 2023.

Aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të karakterizohet me rritje më të ngadalësuar krahasuar me vitin e kaluar. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 1.6 përqind në TM3 2021, ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 4.3 përqind. Në anën tjetër, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 6.5 përqind, ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 6.2 përqind.

Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rikuperim të aktivitetit ekonomik pas goditjes së shkaktuar nga pandemia Covid-19. Në TM3 2021 aktiviteti ekonomik në këto vende u karakterizua me rritje mesatare prej 11.6 përqind. Të gjitha vendet shënuan rritje të aktivitetit ekonomik, ndërsa rritja më e lartë është shënuar në Mal të Zi (25.8 përqind) dhe Kosovë (14.5 përqind). Parashikimet e FMN-së sugjerojnë se aktivitetit ekonomik në rajon do të shënoj rritje mesatare prej 5.3 përqind në vitin 2021.

Ngritje e shkallës së inflacionit u raportua edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si pasojë e rritjes së kërkesës së brendshme dhe rritjes së çmimeve në

tregjet ndërkombëtare. Shkalla mesatare e inflacionit në TM3 2021 ishte 3.7 përqind, ku Kosova dhe Serbia regjistruan shkallën më të lartë të rritjes së inflacionit prej 4.4 përkatësisht 4.3 përqind, ndërsa Shqipëria regjistroi shkallën më të ulët (2.4 përqind).

Vendet e Ballkanit Perëndimorë shënuan rritje të aktivitetit kreditues prej 8.2 përqind. Norma më e lartë e rritjes është shënuar në Kosovë (12.2 përqind), pasuar nga Mali i Zi (9.0 përqind), Shqipëria (7.0 përqind) dhe Serbia e Maqedonia e Veriut (6.4 përqind secila). Depozitat shënuan rritje mesatare prej 13.2 përqind, që është norma më e lartë e rritjes vitet e fundit. Edhe tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Mal të Zi dhe Kosovë (20.9 përkatësisht 15.1 përqind), pasuar nga Serbia (11.9 përqind), Shqipëria (9.9 përqind) dhe Maqedonia e Veriut (8.3 përqind).

Gjatë TM3 2021, euro është vlerësuar ndaj lirës turke (18.9 përqind), dollarit amerikan (0.8 përqind) dhe frankës zvicerane (0.7 përqind), ndërsa është zhvlerësuar ndaj sterlinës britanike (5.5 përqind), lekut shqiptar (1.7 përqind), kunës kroate (0.4 përqind), etj.


Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Si rezultat i lehtësimit të masave kufizuese për ruajtjen e shëndetit të publikut, aktiviteti ekonomik është karakterizuar me rikuperim të aktivitetit ekonomik në vitin 2021. Sipas vlerësimeve të ASK-së, BPV-ja reale ka shënuar rritje prej 12.1 përqind deri në shtator 2021, përderisa vetëm në TM3 2021, është

shënuar rritje prej 14.5 përqind. Eksportet neto kontribuan pozitivisht me 12.8 pikë përqindje, ndërsa konsumi dhe investimet kontribuan pozitivisht me 1.7 përkatësisht 0.1 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së në TM3 2021 (grafik 2).

Grafik 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.


Sipas ASK-së, rritja më e lartë e BPV-së në TM3 2021 është shënuar në sektorin e hoteleve dhe restoranteve (95.5 përqind), transportit dhe magazinimit (33.3 përqind), tregtisë (29.1 përqind), etj. Në anën tjetër, në sektorin e furnizimit me energji elektrike dhe atë të ndërtimitarisë është shënuar rënie prej 24.7 përkatësisht 4.1 përqind.

Vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se trendi i rritjes së aktivitetit ekonomik ka vazhduar edhe në TM4 2021. Këto vlerësime mbështeten në indikator të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që tregojnë për rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në periudhën raportuese, rritjen e remitencave, IHD-ve, etj. Në anën tjetër, rritja shumë e lartë e importit të mallrave dhe shërbimeve ka ndikuar negativisht rritjen reale të BPV-së në periudhën raportuese.

Çmimet

Rikuperimi i aktivitetit ekonomik si dhe rritja e çmimeve në tregjet e jashtme janë reflektuar në rritje të çmimeve edhe në Kosovë. Në TM3 2021 është shënuar normë mesatare e inflacionit prej 4.3 përqind (grafik 3).

Grafik 3. Inflacioni i përgjithshëm, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Trendi i rritjes pritet të vazhdoj edhe në muajt në vazhdim dhe sipas parashikimeve të BQK-së, shkalla mesatare e inflacionit për vitin 2021 do të jetë 3.2 përqind.

Tabela 1. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin gjatë TM3 2021

Përshkrimi	Peshat 2021	Norma e inflacionit	Kontributi
GJITHSEJ	100.0%	4.3	4.3
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	39.9%	3.1	1.3
Pijet alkoolike dhe duhani	6.4%	3.3	0.2
Veshmbathja	4.2%	-0.6	0.0
Strehimi, uji, energjia elektrike	7.8%	2.4	0.2
Orenditë	7.7%	1.7	0.1
Shëndetësia	2.1%	0.5	0.0
Transporti	15.8%	11.0	1.6
Komunikimi	3.3%	16.3	0.5
Rekreacioni dhe kultura	4.2%	2.9	0.1
Arsimi	1.0%	1.1	0.0
Hoteleria	3.1%	1.3	0.0
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.6%	1.2	0.2

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Të ngjashme me parashikimet e BQK-së janë edhe pritjet e bankave, të cilat, kanë deklaruar se presin që niveli i inflacionit do të jetë 3.4 përqind në vitin 2021.

Rritje e çmimeve në TM3 2021 është shënuar tek mjetet e komunikimit, transporti, pijet alkoolike dhe duhani, ushqimi dhe pijet joalkoolike, etj. Në anën tjetër, vetëm çmimet e veshmbathjes kanë shënuar rënie të çmimeve (tabela 1).

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore¹ deri në shtator të vitit 2021 shënuan rritje prej 32.6 përqind, ndërsa shpenzimet buxhetore² shënuan rritje prej 3.2 përqind. Vetëm në TM3 2021, të hyrat buxhetore arritën vlerën neto 628.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 38.2 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore në këtë tremujor shënuan rënie prej 8.3 përqind dhe arritën vlerën 496.2 milionë euro. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 132.5 milionë euro gjatë këtij tremujori.

Rikuperimi i aktivitetit ekonomik rezulton të ketë ndikuar në një rritje të konsiderueshme të të hyrave tatimore direkte prej 22.8 përqind në TM3 2021. Tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore e të hyrave tatimore direkte, shënoi rritje prej 20.5 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje prej 13.6 përqind. Me rritjen e kërkesës së brendshme, e cila ka ndikuar në rritjen e importit të mallrave, është shënuar rritje prej 44.5 përqind edhe në të hyrat tatimore indirekte, të cilat dominojnë të hyrat buxhetore me rreth 77 përqind. Në TM3 2021, të hyrat tatimore indirekte shënuan vlerën prej 484.8

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga financimi.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

milionë euro, ku TVSH-ja dhe akciza si dy kategoritë kryesore të tatimeve indirekte shënuan rritje prej 45.0 përkatësisht 47.1 përqind.


Sa i përket shpenzimeve buxhetore, kategoria kryesore që kontribuoi në zvogëlimin e shpenzimeve buxhetore gjatë TM3 2021 ishte ajo e shpenzimeve kapitale, e cila shënoi vlerën prej 92.8 milionë euro apo 16.9 përqind më pak krahasuar me TM3 2020. Edhe subvencionet dhe transferet shënuan rënie të konsiderueshme prej 10.6 përqind dhe shënuan vlerën prej 176.7 milionë euro. Shpenzimet për paga shënuan rënie prej 3.6 përqind dhe shënuan vlerën prej 158.0 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje të lehtë prej 0.9 përqind dhe arritën vlerën 68.6 milionë euro.

Borxhi publik në TM3 2021 ka arritur në 1.66 miliardë euro, që është për 23.4 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2020. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 23.0 përqind, nga 19.9 përqind sa ishte në TM3 2020. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të jashtëm publik për 39.8 përqind (që ka arritur në 569.5 milionë euro), si dhe rritjes së borxhit të brendshëm prej 16.2 përqind (që ka arritur në 1.09 miliardë euro). Pragu i borxhit publik i paraparë me ligj në Kosovë është 40 përqind e BPV-së, rrjedhimisht niveli i borxhit publik prej 23.0 përqind e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Sidoqoftë, ky nivel i ulët i borxhit publik mund të rritet shpejt në të ardhmen si rezultat ndikimeve negative të pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës dhe planeve të qeverisë për ta financuar deficitin buxhetor nëpërmjet borxhit publik.

Sektori i Jashtëm

Kanali kryesor përmes të cilit është transmetuar kriza ekonomike dhe sociale e nxitur nga pandemia Covid-19 në Kosovë ka qenë sektori i jashtëm i ekonomisë. Megjithatë, deri në shtator 2021, deficitin e llogarisë rrjedhëse ka shënuar rënie prej 5.3 përqind, përdërisanë TM3 2021, është shënuar bilanc pozitiv prej 148.3 milionë euro (-97.9 milionë euro në TM3 2020) (grafik 4).

Grafik 4. Deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro



Burimi: BQK.


Ky përmirësim i bilancit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilancit pozitiv të shërbimeve dhe të ardhurave dytësore, ndërkohë që bilanci i mallrave dhe ai i të ardhurave parësore është përkeqësuar.

Me zbutjen dhe eliminimin e masave kufizuese, edhe tregtia me shërbime ka shënuar rritje të përshpejtuar në vitin 2021. Në TM3 2021, bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 668.0 milionë euro, nga 146.5 milionë euro sa ishte në TM3 2020.

Vlera e eksportit të shërbimeve arriti në 973.9 milionë euro, nga 336.2 milionë euro sa ishte në TM3 2020. Rritjen më të lartë e shënuan eksporti i shërbimeve të udhëtimit dhe transportit, ku si rezultat i numrit më të madh të diasporës që e vizituan Kosovën, eksporti i

shërbimeve të udhëtimit vetëm në këtë tremujor arriti vlerën prej 864.0 milionë euro (246.3 milionë euro në TM3 2020). Edhe importi i shërbimeve ka shënuar rritje në TM3 2021, ku vlera e shërbimeve të importuara ishte 306.0 milionë euro (189.7 milionë euro në TM3 2020). Edhe tek importi, rritja më e lartë është shënuar tek importi i shërbimeve të udhëtimit dhe transportit. Vlen të theksohet se eksporti dhe importi i shërbimeve ishte më i lartë edhe krahasuar me TM3 2019 për 18.0 përkatësisht 8.0 përqind.


Grafik 5. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Eksporti³ i mallrave në TM3 2021 ka shënuar rritje për 65.7 përqind ndërsa importi i mallrave është rritur për 48.0 përqind. Përkundër normës më të lartë të rritjes së eksportit, niveli dukshëm më i lartë i importit ka ndikuar që deficitin tregtar i mallrave të rritet për 45.2 përqind duke arritur nivelin prej 1.1 miliardë euro (grafik 5). Vlera e eksportit të mallrave gjatë TM3 2021 ishte 196.6 milionë euro dhe pothuajse të gjitha kategoritë e eksportit shënuan rritje, ndërsa rritja më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, është shënuar tek metalet bazë, produktet minerale, produktet e plastikës, etj. (grafik 6).

Grafik 6. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Rreth 34 përqind e mallrave të eksportuara përbëhet nga produktet e metaleve bazë dhe ndryshimet në çmimet e metaleve në tregjet ndërkombëtare reflektojnë në vlerën nominale të eksporteve. Çmimet e metaleve bazë në TM3 2021 shënuan rritje prej 46.3 përqind dhe kjo ka ndikuar në rritjen e eksportit të metaleve prej 114.1 përqind. Gjithashtu, edhe indeksi i çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare por edhe ai i çmimeve të ushqimit ka shënuar rritje prej 92.0 përkatësisht 32.3 përqind ndërkohë që rritja e eksportit të mineraleve (përfshihet edhe energjia elektrike) dhe ushqimeve të përgatitura ishte 62.3 përkatësisht 24.6 përqind në TM3 2021.


Vendet e CEFTA-s dhe vendet e BE-së përfaqësojnë partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës për eksporte, me pjesëmarrje prej 38.5 përkatësisht 30.6 përqind të gjithsej eksporteve në TM3 2021. Eksportet drejt vendeve të CEFTA-s vetëm në TM3 2021 ishin 75.8 milionë euro, një rritje prej 50.4 përqind, ndërsa eksporti i mallrave në vendet e BE-së ishte 60.2 milionë euro apo 29.8 përqind më shumë krahasuar me TM3

³ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

2020. Eksportet drejt SHBA-së kanë vazhduar të karakterizohen me një trend të lartë rritës. Në TM3 2021, pjesëmarrja e SHBA-ve në gjithsej eksportin e mallrave ishte 15.3 përqind nga vetëm 6.9 përqind sa ishte në TM3 2020.

Vlera e importit të mallrave gjatë TM3 2021 ishte 1.3 miliardë euro, që paraqet rritje prej 48.0 përqind. Sikurse tek eksporti i mallrave, edhe rritja e lartë e importit të mallrave, përveç rritjes së kërkesës vendore, është ndikuar edhe nga rritja e lartë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Grafik 7. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Pothuajse të gjitha kategoritë e importit kanë shënuar rritje, ndërkohë që rritjen më të lartë e ka shënuar importi i produkteve minerale (përfshihet edhe importi i derivateve të naftës), pastaj mjetet e transportit, ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, metalet bazë, etj. (grafik 7).


Çmimet e naftës së papërpunuar janë rritur për 70.5 përqind në TM3 2021, ndërkohë që importi i produkteve minerale, si njëra ndër kategoritë kryesore të importit të mallrave, është rritur për 114.1 përqind.

Sa i përket importit sipas vendeve, vendet e BE-së dhe vendet anëtare të CEFTA-s janë vendet prej nga Kosova importon pjesën më të madhe të mallrave. Në TM3 2021, Kosova importoi 41.8 përqind të gjithsej importeve nga vendet e BE-së apo 39.9 përqind më shumë krahasuar me TM3 2020, si dhe 19.1 përqind të gjithsej importeve nga vendet e CEFTA-s apo 34.4 përqind më shumë krahasuar me TM3 2020. Një pjesë e madhe e importit të mallrave është realizuar edhe nga Turqia dhe Kina. Importi i mallrave nga Turqia ishte 11.7 përqind e gjithsej importit apo 34.1 përqind më shumë krahasuar me TM3 2020, ndërsa importi i mallrave nga Kina, kishte një pjesëmarrje prej 9.6 përqind në gjithsej importin e mallrave apo 40.9 përqind më shumë krahasuar me TM3 2020.

Llogaria e të ardhurave parësore shënoi rënie për 35.0 përqind në TM3 2021, kryesisht si rezultat i të ardhurave nga investimet, ndërkohë që edhe të ardhurat neto nga kompensimi i punëtorëve shënuan rënie të lehtë. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 10.3 përqind, si rezultat i nivelit më të lartë të remitencave. Norma e lartë e rritjes së remitencave në vitin 2020, përkundër situatës së vështirë të krijuar nga pandemia Covid-19, ka vazhduar edhe në vitin 2021. Vetëm në TM3 2021, niveli i remitencave ishte 306.9 milionë euro apo 17.1 përqind më shumë krahasuar me TM3 2020 (grafik 8).

Sa i përket kanaleve të transferimit, gjysma e remitencave (50.1 përqind) kanë ardhur përmes agjencive për transferim të mjeteve por që në TM3 2021 shënuan rënie prej 20.6 përqind. Remitencat përmes bankave shënuan rritje prej 31.1 përqind dhe përbëjnë 18.0 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në TM3 2021.


Grafik 8. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK.

Si rezultat i hapjes së kufijve dhe relaksimit të masave edhe remitencat përmes kanalit 'jo-formal' janë rritur dhe kanë arritur nivelin prej 97.9 milionë euro vetëm në TM3 2021 nga 26.5 milionë euro sa ishin në TM3 2020. Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, me 40.4 përkatësisht 18.1 përqind të gjithsej remitencave në gjysmën e parë të vitit 2021. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të (7.0 përqind e gjithsej remitencave).

Grafik 9. Struktura e investimeve të huaja direkte, në milionë euro



Burimi: BQK.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) arritën vlerën prej 165.2 milionë euro në TM3 2021, që paraqet rritje prej 106.1 përqind. Rritja e lartë e IHD-ve kryesisht i


atribuohet rigjallërimit ekonomik, që u përkthye në rritje më të lartë të fitimit të ri-investuar. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti në 167.5 milionë euro, ndërsa instrumentet e borxhit shënuan rënie për 2.3 milionë euro (grafik 9).

Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e patundshmërive, aktivitetëve financiare dhe të sigurimit, transportit, etj. ndërsa në sektorin e prodhimit, tregtisë, etj. është shënuar rënie e IHD-ve.

Sistemi Financiar

Sistemi financiar gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje të përshpejtuar, kryesisht si rrjedhojë e ecurisë pozitive të sektorit bankar dhe pensional. Kontributi pozitiv i sektorëve tjerë në këtë rritje ishte i limituar për shkak të peshës së ulët në gjithsej asetet e sistemit financiar.


Grafik 10. Vlera e aseteve e sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK.

Në fund të shtatorit 2021, asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 8.59 miliardë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 12.1 përqind (grafik 10).

Grafik 11. Koncentrimi në asetet e sistemit financiar, sipas sektorëve përbërës



Kjo rritje dyshifrore kryesisht i'u atribua rritjes së nivelit të depozitave në sektorin bankar, si dhe performancës pozitive financiare të fondeve pensionale deri në shtator 2021 dhe arkëtimeve të reja nga kontribut-dhënësit.

Sektori bankar vazhdon të ketë peshën kryesore në kuadër të sistemit financiarë dhe përbën burimin kryesor financues për bizneset dhe ekonomitë familjare (grafik 11). Sektori pensional përfaqëson 25.9 përqind të tregut financiar në vend, pasuar nga institucionet mikrofinanciare, sigurimet dhe ndihmësit financiar.


1.0 Sektori Bankar

Përkundër rreziqeve të rritura si pasojë e pasigurive të shkaktuara nga pandemia Covid-19, sektori bankar ka vazhduar të mbajë nivel të lartë të kapitalizimit, likuiditetit dhe profitabilitetit, si dhe cilësi të lartë të portfolios kreditore. Aktiviteti kredidhënës ka vazhduar trendin rritës që kishte para shfaqjes së pandemisë, kurse depozitat vazhduan të rriten me ritëm të lartë.

1.1 Bilanci i gjendjes - Asetet

Sektori bankar në vitet e fundit është zgjeruar me ritëm të përsheptuar, përkundër sfidave të shkaktuara nga Covid-19, duke u mbështetur në nivelin e lartë të depozitave të arkëtuara. Në shtator 2021, gjithsej asetet e sektorit bankar arritën vlerën në 5.76 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.4 përqind (grafik 12). Struktura e aseteve nuk ka pësuar ndryshime të mëdha me periudhat e kaluara. Kreditë vazhdojnë të jenë kategoria me peshën më të madhe në kuadër të aseteve (62.0 përqind), pasuar nga ajo e letrave me vlerë (11.6 përqind), parasë së gatshme (12.1 përqind), investimeve (depozitave) të mbajtura në bankat tjera (11.1 përqind), dhe pjesa e mbetur nga asetet tjera.

Grafik 12. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




Investimet në letrat me vlerë janë kryesisht të orientuara drejt bonove të thesarit dhe fletë-obligacioneve qeveritare vendore dhe të huaja. Mirëpo, në dy vitet e fundit ka rritje të investimeve në letra me vlerë jo-qeveritare, të cilat kanë rrezik më të lartë, por edhe kthim më të lartë në investime. Pështja e tyre ka arritur në 6.7 përqind të gjithsej letrave me vlerë, nga 2.4 përqind sa ishte në shtator të vitit 2019. Mjetet e

mbajtura në bankat tjera janë kryesisht në formë të llogarisë rrjedhëse dhe atë të afatizuar, të cilat shfrytëzohen edhe për të kryer transaksione ndërkombëtare të klientëve të bankave.

1.1.1 Aktiviteti kredidhënës

Aktiviteti kredidhënës shënoi rritje të përshpejtuar krahasuar me vitin e kaluar, duke vazhduar trendin e rritjes para-pandemike (grafik 13). Në shtator 2021, gjithsej kreditë arritën në 3.57 miliard euro, një rritje vjetore 12.2 përqind (7.6 përqind në periudhën paraprake). Në këtë rritje kontribuuan si sektori i ekonomive familjare, që shënoi rritje të përshpejtuar, edhe ai i korporatave jofinanciare që njëherësh kishte kontributin kryesor në rritjen e gjithsej kredive.

Grafik 13. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Rritja e përshpejtuar e kreditimit ndaj ekonomive familjare dhe sektorit të ndërmarrjeve kryesisht i është atribuar rritjes së ofertës kreditore nga bankat mbështetur në prospektet pozitive makroekonomike me rikuperimin ekonomik, nivelit të lartë të likuiditetit dhe pozicionit të kapitalit, cilësisë së mirë të portofolit kreditor, mbështetjes nga FKGK dhe Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike, etj. Njëkohësisht,

edhe kërkesa për kredi rezulton të jetë rritur nga të dy segmentet.

Edhe sa i përket ecurisë së kredive të reja, ato kompensuan ecurinë e vitit të kaluar, duke shënuar rritje të përshpejtuar përgjatë vitit 2021 (deri në shtator) (grafik 14). Kjo ishte më e evidentuar tek sektori i ekonomive familjare, kreditimi ndaj të cilave u rrit për 51.4 përqind (-7.6 përqind - deri në shtator 2020). Kontributin kryesor në rritje e kredive të reja ndaj ekonomive familjare vazhdojnë të kenë ato për qëllime konsumi, që shënuan rritje vjetore prej 45.1 përqind (-8.3 përqind në periudhën paraprake) – dhe kanë një përfaqësim prej 70 përqind. Kurse, kreditë e reja hipotekare, që kanë një përfaqësim prej 25 përqind në gjithsej kreditë e reja ndaj sektorit të ekonomive familjare, shënuan rritjen më të lartë gjatë kësaj periudhe, prej 75.8 përqind (2.0 përqind në periudhën paraprake).

Grafik 14. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Në rritje të theksuar të kredive hipotekare ka ndikuar ofrimi i kushteve më të favorshme nga bankat për këtë kategori, përmes normës së ulët të interesit dhe zgjatjes së afatit të maturitetit.

Kreditë e reja ndaj korporatave jofinanciare, që kanë peshën më të madhe në gjithsej kreditë e lëshuara (prej 53.7 përqind), u zvogëluan për 2.8 përqind gjatë kësaj periudhe (rritje për 5.7 përqind në periudhën paraprake). Në këtë rënie ndikimin më të lartë kishte ecuria e kredive të reja me qëllimi investues, (rënie për 25.8 përqind), që kanë dhe peshën më të madhe në gjithsej kreditimin ndaj korporatave jofinanciare.


Grafik 15. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.

Kurse, kreditë e reja jo-investuese shënuan rritje për 54.1 përqind (rënie për 29.1 përqind deri në shtator 2020).

Grafik 16. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare vazhdon të dominohet prej sektorit të tregtisë, pasuar nga ai i

prodhimtarisë, përderisa sektori i bujqësisë vazhdon të ketë peshën më të ulët (grafik 15).


Kreditë ndaj sektorit të tregtisë u rritën për 8.4 përqind (8.0 përqind në shtator 2020) dhe kishin kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit të korporatave jofinanciare. Kurse, kreditimi ndaj sektorit të prodhimtarisë shënoi rritjen më të lartë gjatë kësaj periudhe. Përderisa, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë shënoi tkurrje të konsiderueshme krahasuar me periudhën paraprake (grafik 16).

Në përgjithësi, deri në shtator 2021, sektori bankar u zgjerua me ritëm më të shpejtë, e reflektuar nga ecuria e depozitave. Kurse, ecuria e kreditimit të sektorit arriti në nivele parapandemike, dhe pritet që edhe përgjatë pjesës së mbetur të vitit dhe vitit të ardhshëm të ruaj këtë nivel.

1.2 Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar vazhdon të jetë tradicionale dhe përbëhet kryesisht nga depozitat (81.0 përqind), burimet vetanake (12.3 përqind), dhe obligimeve tjera.

Grafik 17. Bilanci i gjendjes i sektorit bankar - detyrimet dhe ekuiteti




Burimi: BQK.

Historikisht, depozitat kanë paraqitur një burim të sigurt financues dhe me kosto mjaftë të ulët.

1.2.1 Depozitat

Vlera e depozitave të mbajtura nga sektori bankar në fund të shtatorit arritën vlerën prej 4.67 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.1 përqind (grafik 18 dhe 19).


Grafik 18. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.

Depozitat e arkëtuara prej ekonomive familjare vazhdojnë të kenë kontributin kryesor në rritje të gjithsej depozitave, pasuar nga depozitat e arkëtuara prej korporatave jofinanciare.


Grafik 19. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje



Burimi: BQK.

Depozitat e korporatave tjera financiare (kryesisht fondet pensionale) shënuan rënie, kryesisht për shkak të ri-alokimit të mjeteve në sektorin e jashtëm.

Grafik 20. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.


Depozitat e ekonomive familjare, që përfaqësojnë rreth 68.5 përqind të gjithsej depozitave, shënuan rritje vjetore prej 18.3 përqind në shtator 2021 (7.0 përqind në shtator 2020), kryesisht si rezultat i probabilitetit më të lartë të kursimit në kohë pasigurie kundrejtë shpenzimit, si dhe fluksit më të lartë të ardhjes së diasporës dhe remitancave të dërguara.

Edhe niveli i depozitave të mbajtura në sektorin bankar prej korporatave jofinanciare shënoi rritje gjatë kësaj perudhe (28.4 përqind), e që mund të reflektoj deri në një masë edhe pasigurinë e një pjese të bizneseve për të bërë investime kapitale, veçanërisht atyre të cilave mbyllja potenciale e ekonomisë apo ashpërsimi i masave mund të ndikonin negativisht në qarkullim të biznesit të tyre. Deri në shtator 2021,

vlera e depozitave të reja të arkëtuara⁴ arriti në 327.8 milionë euro, për 0.2 përqind përqind më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafik 20).

Vlera e ulët e depozitave të reja të arkëtuara në vitet e fundit reflekton nivelin e ulët të normave të interesit për depozitat e afatizuara⁵, struktura e të cilave në vitet e fundit është tkurrur kundrejt rritjes së atyre të transferueshme (grafik 21).

Grafik 21. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.


Niveli i ulët i normave të interesit në depozita reflekton likuiditetin e lartë në sektorin bankar.

Depozitat e reja të arkëtuara nga korporatat jofinanciare (depozitat e afatizuara) gjatë kësaj periudhe shënuan rënie për 25.7 përqind, dhe arritën vlerën prej 71.6 milionë euro në fund të periudhës. Kurse, depozitat e reja të arkëtuara nga ekonomitë familjare (depozitat e afatizuara), deri në shtator 2021 arritën vlerën prej 256.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 10.4 përqind.

1.3 Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi kanë shënuar rënie graduale ndër vite, duke arritur në nivel të përafërt me vendet e rajonit. Kurse, norma mesatare e interesit në depozita ka mbetur pothuajse e pandryshuar në vitet e fundit, që kryesisht ka reflektuar nivelin e lartë të likuiditetit të bankave. Në shtator 2021, norma e interesit në kredi ishte 5.9 përqind kurse ajo për depozita në 1.4 përqind, duke ngushtuar margjinën kredi-depozitë në 4.5 pikë përqindje (grafik 22).

Grafik 22. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.


1.3.1 Normat e interesit në kredi

Normat e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare deri në një masë janë më të favorshme krahasuar me ato ndaj ekonomive familjare (grafik 23). Në shtator 2021, norma e interesit për kreditë ndaj korporatave jofinanciare qëndroi në 5.7 përqind (6.2 përqind në shtator 2020) (grafik 23).

⁴ Depozita e reja përfshijnë depozitat e afatizuara.

⁵ Norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara në sektorin bankar gjatë periudhës janar-shtator 2021 ishte 1.4 përqind.

Grafik 23. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare




Burimi: BQK.

Normat e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve dhe të industrisë janë më të favorshme krahasuar me ato për sektorin e bujqësisë.

Normat më të larta të interesit në kredi për sektorin e bujqësisë janë rezultat i rrezikut më të lartë që mbart ky sektor, megjithëse në vitet e fundit është evidentuar rënie e kostos së financimit edhe për këtë sektor (grafik 23).

Grafik 24. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare vazhduan trendin rënës, por me ritëm më të ngadalësuar. Norma e interesit për këtë segment në shtator 2021 qëndroi në 6.1 përqind. Normë më të favorshme të interesit kishin kreditë hipotekare – që reflekton dhe rritjen e lartë të kredive të reja

hipotekare përgjatë vitit 2021. Ndërsa, normat e interesit për kreditë konsumuese ishin më të larta se sa mesatarja e segmentit, por krahasuar me periudhat paraprake, kemi poashtu rënie të konsiderueshme (grafik 24).

1.3.2 Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita vazhdojnë të qëndrojnë në nivele të ulëta, me norma më të favorshme për korporatat jofinanciare (2.1 përqind) krahasuar me ato për ekonomitë familjare (1.2 përqind) (grafik 25).

Grafik 25. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.


Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar deri në shtator 2021 realizoi fitim në vlerë prej 90.1 milionë euro, e që është për 32.9 milionë euro më i lartë krahasuar me gjendjen në fund të shtatorit 2020 (grafik 26). Fitimi më i lartë i realizuar këtë periudhë reflekton ecurinë e të hyrave (të cilat u rritën për 14.8 përqind) dhe shpenzimeve (të cilat u zvogëluan për 1.5 përqind).

Në kuadër të hyrave, të hyrat nga interesi janë kategoria me peshën më të madhe (69.9 përqind) dhe shënuan rritje vjetore prej 5.1 përqind, rritje kryesisht

e atribuar të ardhurave nga interesi në kredi. Të hyrat nga jointerisi që kanë peshë më të ulët në gjithsej të hyrat e sektorit (27.0 përqind) kishin kontributin më të lartë në rritje të të ardhurave të sektorit, pasi që shënuan rritje për 37.3 përqind. Nënkatëgoria e cila shënoi rritjen më të lartë ishte ajo e tarifave dhe komisioneve, e që reflekton rritjen e kostos për ofrimin e shërbimeve bankare.

Grafik 26. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK.

Në kuadër të shpenzimeve, kategoria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative që ka peshën më të madhe në gjithsej shpenzimet (58.4 përqind) shënoi rritje vjetore prej 8.1 përqind gjatë kësaj periudhe. Ndërsa, kategoria e dytë me peshën më të madhe, ajo e shpenzimeve të jointerisit (22.0 përqind), shënoi rënie vjetore prej 13.2 përqind si pasojë e rënies së shpenzimeve për provizionimin nga humbjet e mundshme në kredi. Kjo nënkategori kishte dhe kontributin më të lartë në rënie të gjithsej shpenzimeve këtë vit. Kategoria e shpenzimeve për interesa përfaqëson vetëm 12.6 përqind të gjithsej shpenzimeve dhe shënoi rritje vjetore prej 4.6 përqind këtë periudhë si rezultat i rritjes së shpenzimeve tjera nga interesi.

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar ka trashëguar nga vitet e kaluara nivel të lartë të kapitalizimit, likuiditetit dhe portfolio me cilësi të lartë kreditore.


Grafik 27. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione



Burimi: BQK.

Kjo ka ndikuar që edhe gjatë periudhës kritike të pandemisë Covid-19 gjatë vitit të kaluar, sektori bankar të përballoj këtë krizë të paprecedent pa u përkeqësuar portfolio kreditore e bankave dhe sektorit në përgjithësi.

Grafik 28. Treguesi i solvencës




Burimi: BQK.

Niveli i kredive joperformuese në shtator 2021 ishte 2.4 përqind dhe me mbulueshmëri me provizione nga humbjet e mundshme prej 144.4 përqind (grafik 27).

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në nivel prej 17.9 përqind, dukshëm mbi nivelin minimal me rregullore prej 12.0 përqind (grafik 28).

Grafik 29. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

Po ashtu, edhe likuiditeti i sektorit qëndroi në nivel më të lartë krahasuar me periudhën paraprake. Pra, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve

afatshkurtra shënoi përmirësim për 2.1 pikë përqindje krahas gjendjes në fund të shtatorit 2020, duke qëndruar në nivel prej 39.8 përqind (grafik 29).

Në përgjithësi, sektori bankar vazhdon të operoj në një ambient me nivel të ulët të kredive me probleme, likuiditet të lartë dhe mirë të kapitalizuar.

Kjo ka rezultuar që sektori të ndaj më pak shpenzime për provizione për humbjet e mundshme në kredi, nivel më të ulët të shpenzimeve për interesa.


Të hyrat stabile nga interesi dhe ato në rritje prej tarifave dhe komisioneve kanë ndikuar në rritje të fitimit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe.

Kuti informuese

Bankat me rëndësi sistematike⁶

- Në sektorin bankar pesë bankat më të mëdha kanë rezultuar me rëndësi të përgjithshme sistematike (grafik 1)


Grafik 1. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistematike



Burimi: BQK.

- Në kriteret e veçanta, bankat e rëndësisë së përgjithshme sistematike kanë rezultuar të tilla edhe në kriteret përbërëse (përfshirë ato të ndërlidhjes) (grafik 2).
- Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit ka nivelin më të lartë të pikëve sistematike, për shkak që qasja në financim me sektorin e jashtëm është më e limituar për bankat e vogla krahasuar me ato të mëdha. Po ashtu, vetëm disa banka shfrytëzojnë këtë të drejt, andaj kemi koncentrim më të lartë në këtë kriter.

Grafik 2. Shkalla e rëndësisë sistematike, sipas kriterëve




Burimi: BQK.

Kapitali shtesë kundërciklik⁷


- Kalkulimi i kapitalit të nevojshëm shtesë është bërë sipas udhëzimeve përkatëse nga Komiteti i Bazelit me ç'rast kërkesa për kapital shtesë (në përqindje të aseteve të peshuara me rrezik) është zero atëherë kur hendeku është më i vogël se 2 pikë përqindje, dhe me rritjen e hendekut mbi vlerën 2 deri në 10 pikë përqindje kërkohet mbajtje e kapitalit shtesë deri në nivelin maksimal 2.5 përqind.

Grafik 3. Hendeku i kreditimit



Burimi: BQK.

Grafik 4. Kapitali shtesë kundër-ciklik



Burimi: BQK.

- Kurse, me të dhënat e shtatorit 2021, hendeku kredi/BPV ishte nën pragun prej 2.0 pikë përqindje, përkatësisht 1.110 (grafik 3), që nënkupton që sektori bankar nuk ka nevojë për kapital shtesë ndaj mjeteve të peshuara me rrezik (grafik 4).


⁶ Për bazën teorike dhe metodologjinë e plotë të vlerësimit të Bankave me Rëndësi Sistematike, shih Materialin Studimor nr. 7 të BQK-së me titull 'Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistematike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë'.

⁷ Banka për Ndërmjetësimë Ndërkombëtare (2010). Udhëzimet për autoritetet nacionale që operojnë shtesën e kapitalit kundër-ciklik, Komiteti për Mbikëqyrje Bankare i Bazelit.

Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar⁸

- *Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar është ndërtuar mbështetur në tregues me frekuencë të shpeshtë të sektorit bankar, për matjen dhe vlerësimin e kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit bankar. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas.*
- *Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, në mesatare, është shënuar ulje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut (lexo: rritje të indeksit) në TM3 2021 krahasuar me TM3 2020.*
- *Vlera e përgjithshme e indeksit në TM3 2021 është mbi vlerën mesatare të indeksit (grafik 5), për dallim nga viti paraprak ku si pasojë e krizës pandemike, indeksi i përgjithshëm rezultoi të jetë nën vlerat mesatare historike në secilin tremujor.*

Grafik 5. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar dhe kriterëve përbërës




- *Përmirësimi i indeksit të përgjithshëm të stabilitetit të sektorit bankar, që për qëllim ka të mat ndjeshmërinë ndaj rreziqeve kryesore prej të cilave mund të goditet sektori bankar, erdhi si rezultat i nivelit të lartë të likuiditetit, rikuperimit të trendit rritës të kredive me periudhën para-pandemike, nivelit të ulët të KJP-ve, dhe nivelit të lartë të kapitalizimit (të trashëguar dhe prej fitimit të realizuar gjatë kësaj periudhe).*

Sektori pensional

Performanca e kënaqshme në tregjet financiare, si rezultat i stabilizimit deri në një masë të ekonomisë globale, u reflektua në rritjen e aseteve të sektorit pensional. Kjo rritje i atribuohet kryesisht kthimit të konsiderueshëm pozitiv në investime dhe kontributeve të arkëtuara nga kontribut-dhënësit.

Sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, përbën 25.9 përqind të gjithëj aseteve të sistemit financiar. Asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 7.1 përqind në shtator 2021 dhe arritën vlerën prej 2.23 miliardë euro (grafik 30). Rritja e aseteve kryesisht reflekton rritjen e kontributeve të reja dhe kthimin në investime gjatë periudhës Janar – Shtator 2021.

Grafik 30. Asetet e sektorit pensional




Burimi: BQK.

Asetet e sektorit pensional përbëhen 99.6 përqind nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe 0.4 përqind nga asetet e Fondit Sllloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP).

⁸ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.

Struktura e aseteve e FKPK-së përbëhet kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit, ndër vite pesha e tyre gradualisht është zvogëluar kundrejt rritjes së peshës së mjeteve të investuara në vend. Rreth 74.5 përqind e mjeteve të FKPK-së janë të mbajtura jashtë vendit. Saktësisht, në vlera monetare, rreth 1.65 miliardë euro janë të alokuara në fonde të përbashkëta investuese dhe 5.5 milionë euro janë para në banka (tranzit) (grafik 31).

Grafik 31. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM3 2021)




Burimi: FKPK.

Pjesa e mbetur e mjeteve u investuan brenda vendit, dhe arritën vlerën prej 564.8 milionë euro në fund të shtatorit 2021. Këto mjete janë kryesisht të investuara në fletë-obligacione dhe bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat vetëm gjatë TM3 2021 u rritën për rreth 10.0 milionë euro, ndërsa nëse e krahasojmë me vitin paraprak, u rritën për 58.9 milionë euro. Paraja e mbajtur në Bankën Qendrore të Kosovës u përgjysmua nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo dinamikë mund të shpjegohet me mbajtjen e rezervave në BQK kundrejt plasimit të tyre në instrumentet financiare në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2020, si pasojë e pasigurisë së shtuar për shkak të ndikimit të pandemisë në aktivitetin ekonomik global. Përderisa, kategoria e njëjtë e

krahasuar me tremujorin paraprak u dyfishua, gjë që jep sinjale për rikthimin në normalitet apo adaptimin e tregjeve financiare me ciklet e pandemisë.

Struktura e aseteve të FSKP-së është e ngjashme me atë të FKPK-së, ku rreth 78.9 përqind e tyre janë të investuara jashtë vendit, dhe pjesa e mbetur në Kosovë. Portfolio e FSKP-së përbëhet kryesisht nga aksionet e investuara jashtë vendit (68.9 përqind), obligacionet e qeverive të huaja dhe të Kosovës (19.5 përqind), paraja e gatshme (4.6 përqind) dhe instrumentet tjera (6.2 përqind) (grafik 32). Gjithsej asetet e FSKP-së deri në shtator 2021 arritën në 9.1 milionë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 11.0 përqind. Rritja e aseteve të fondit reflekton rritjen vjetore të konsiderueshme të investimeve si brenda vendit në letrat me vlerë të Qeverisë, ashtu edhe jashtë vendit në aksione, saktësisht 23.1 përqind dhe 23.6 përqind, respektivisht.


Grafik 32. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM3 2021)



Burimi: FSKP.

Në periudhën janar – shtator 2021, FSKP-ja kishte kthim bruto në investime në vlerë prej 715.7 mijë euro (kthim negativ në investime prej 61.0 milionë euro në vitin paraprak). Ndërsa, vlera e arkëtimeve të reja nga kontribut-dhënësit deri në shtator 2021 arriti në 381.8 mijë euro (392.1 mijë euro deri në shtator 2020).

Deri në shtator 2021, kontributet e arkëtuara të FKPK-së arritën vlerën prej 156.7 milionë euro, një rritje vjetore për 15.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



FKPK realizoi kthim bruto nga investimet në vlerë prej 132.7 milionë euro në periudhën janar-shtator 2021, që përbën rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin paraprak ku kthimi bruto në investime arriti vlerën prej 12.5 milionë euro. Kjo performancë pothuajse arriti nivelin e kthimit në investime të vitit 2019 (137.3 milionë euro). Kontribut kyç në kthimin në investimeve kishte performanca e fondeve në tregjet financiare ndërkombëtare, ku edhe janë të koncentruara mjetet e FKPK-së. Deri në shtator 2021, 92.4 përqind e kthimit në investime erdhi nga investimet jashtë vendit, përderisa 6.8 përqind erdhi nga investimet në vend, kryesisht në formë të letrave me vlerë të Qeverisë dhe depozitave në bankat në vend. Zbatimi i politikave investuese të fondit dhe diversifikimi adekuat sygjerojnë për performancë stabile përmes kthim në investime dhe rritjes së çmimit të njësisë së FKPK gjatë periudhës në vazhdim. Sidoqoftë sektori duhet të aplikoj kujdes të shtuar në menaxhimin e mjeteve për shkak të pasigurive në

tregjet ndërkombëtare si pasojë e rritjes së inflacioni dhe shfaqjes së variantit të ri të virusit, të cilat paralajmërojnë lëvizje të paqëndrueshme të investimeve.


Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve deri në shtator 2021 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit të reflektuar në rritje të asetëve. Njëkohësisht, rritja e primeve të shkruara dhe të hyrave financiare në një anë dhe rënia e shpenzimeve operative në anën tjetër, tejkaluan rritjen e dëmeve të ndodhura. Këto ecuri rezultuan në performancë pozitive të sektorit në shtator 2021.

Asetet e sektorit të sigurimeve deri në fund të muajit shtator 2021 arritën në vlerën 235.7 milionë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 10.0 përqind (grafik 34). Kjo rritje kryesisht u mbështet nga rritja e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, rritja e investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si dhe rritja e pjesës së risiguruesit për rezervat teknike.

Në kuadër të kapitalit dhe detyrimeve, rritjen më të lartë e shënuan rezervat teknike, e në veçanti rezervat për dëmet bruto. Rezervat për primet u rritën gjithashtu, kryesisht për primet e pafituara. Detyrimet e sektorit shënuan rritje për 17.1 milionë euro, apo rritje vjetore prej 10.9 përqind. Njëkohësisht, niveli i përgjithshëm i kapitalizimit të sektorit u karakterizua me rritje. Deri në shtator 2021, gjithsej kapitali u rrit për 4.4 milionë euro, rritje vjetore prej 7.7 përqind, krysisht si rezultat i rritjes së kapitalit aksionar si dhe rritjes së fitimit neto.

Grafik 34. Asetet e sektorit të sigurimeve



Vlera e primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimeve në shtator 2021 arriti në 86.9 milionë euro, një rritje vjetore prej 20.2 përqind (2.2 përqind rënie vjetore në shtator 2020) (grafik 35). Në kuadër të primeve të shkruara bruto, primet e kategorisë ‘jo-jetë’ përbëjnë 96.0 përqind të gjithsej primeve të shkruara, ndërsa ato të kategorisë ‘jetë’ 4.0 përqind.


Vlera e dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve (përfshirë edhe Byronë Kosovare të Sigurimit) shënoi rritje të theksuar në shtator 2021 prej 29.9 përqind kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar (rritje marginale vjetore prej 0.6 përqind). Në shtator 2021, dëmet e paguara arritën vlerën prej 45.6 milionë euro (35.1 milionë euro në shtator 2020) duke shënuar rritje vjetore prej 32.0 përqind (grafik 35). Pasi në përqindje, dëmet gjatë kësaj periudhe patën rritje më të lartë se sa primet e shkruara, raporti dëme/prime u rrit në 52.5 përqind (grafik 35).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Deri në shtator 2021, performanca e sektorit të sigurimeve rezultoi pozitive me fitim neto në vlerë prej 5.9 milionë euro, rritje vjetore prej 35.4 përqind (në vlerë rritje për 1.5 milionë euro).⁹

Përkundër që dëmet e ndodhura shënuan rritje të theksuar deri në shtator 2021, rritja e të hyrave nga primet dhe të hyrave financiare, si dhe rënia e shpenzimeve operative, kontribuan në rezultatin pozitiv financiar të sektorit.

Grafik 35. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Sektori mikrofinanciar


Rritja e aseteve të sektorit, kryesisht e ndikuar nga rritja e aktivitetit kreditor, si dhe rënia e theksuar e shpenzimeve njëkohësisht me rritjen e të hyrave rezultuan në fitimin financiar më të lartë të sektorit që nga konsolidimi i tij. Përkundër pasigurive të lidhura me ecurinë e pandemisë, cilësia e portfolios së kredive të sektorit vazhdoi të mbetet stabile.

⁹ Fitimit neto i është larguar fitim/humbja e kompanisë së sigurimit të cilës i është revokuar licenca në vitin 2019.

Asetet

Sektori mikrofinanciar regjistroi rritje vjetore të aseteve prej 7.6 përqind (5.8 përqind rritje vjetore në shtator 2020), vlera e të cilave arriti në 342.2 milionë euro në fund të shtatorit 2021. Edhe pse ritmi i rritjes së aseteve u përshpejtua kundrejt rritjes së ngadalësuar të vitit paraprak, rritja e aseteve mbeti në nivel dukshëm më të ulët krahasuar me nivelin e rritjes në shtator 2019 (grafik 36).

Grafik 36. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.


Sektori shënoi rënie të theksuar në zërat e parasë së gatshme dhe bilancit me bankat komerciale, përderisa shënoi rritje dyshifrore në kredi dhe lizingje. Ndryshimet në strukturën e aseteve të sektorit sygjeronjë orientimin e mjeteve drejt rritjes së aktivitetit kreditor. Këto lëvizje në sektorin mikrofinanciar pasqyrojnë rikthimin në normalitet të aktivitetit ekonomik në vend, sidomos gjatë tremujorit të tretë, bazuar në lirimin e masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së Covid-19, numrit të madh të vizitave nga diaspora dhe rritjes së remitencave. Me tejkalimin e valës së fundit të infektiveve me Covid-19 në muajin shtator dhe duke u bazuar në pritjet për numër të ulët të infektiveve gjatë tremujorit të fundit

të vitit 2021, mund të sygjerohet për rritje të mëtutjeshme të aktivitetit kreditor në veçanti, si dhe aseteve në përgjithësi. Sidoqoftë, me shfaqjen e varianteve të reja të virusit Covid-19 në vendet e jashtme, vazhdojnë pasiguritë në dinamikat e aktivitetit ekonomik edhe në vend, e që rrjedhimisht do të kishte ndikim edhe në sektorin mikrofinanciar.

Kreditë

Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rritje të përshpejtuar për 12.4 përqind në shtator 2021, përderisa stoku i tyre arriti në 231.0 milionë euro. Kreditimi u rrit për të dy agjentët ekonomik, korporatat jo-financiare dhe ekonomitë familjare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 12.6 përqind (6.5 përqind rënie vjetore në shtator 2020), duke arritur vlerën 152.9 milionë euro në fund të shtatorit 2021 (grafik 37).


Grafik 37. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.

Stoku i kredive ndaj korporatave jo-financiare arriti vlerën prej 78.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.9 përqind (rritje vjetore prej 0.8 përqind në shtator 2020).

Grafik 38. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK.

Në aspekt sektorial, kreditimi ndaj të gjithë sektorëve të ekonomisë shënoi rritje të përsheptuar, përveç sektorit të ndërtimtarisë që kishte rritje të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritjen më të lartë e shënoi sektori i shërbimeve financiare, pasuar nga sektori i 'shërbimeve tjera' (grafik 38).

Lizingjet

Lizingjet u zgjeruan deri në shtator 2021, edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me ritmin e rritjes në vitin paraprak. Aktiviteti i lizingut shënoi rritje vjetore në vlerë prej 6.8 milionë euro (8.4 milionë euro në shtator 2020), dhe arriti vlerën prej 63.6 milionë euro.

Grafik 39. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.


Kjo rritje kryesisht reflekton lizingun ndaj korporatave jo-financiare, vlera e të cilit arriti në 36.9 milionë euro e që paraqet rritje vjetore prej 19.0 përqind (grafik 39).

Lizingu ndaj ekonomive familjare kishte rritje të ngadalësuar në raport me vitin paraprak, duke shënuar rritje vjetore prej 3.6 përqind (17.4 përqind në shtator 2020), përderisa vlera e përgjithshme e tyre në shtator 2021 arriti në 26.6 milionë euro.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga ky sektor në shtator 2021 qëndroi në 20.3 përqind, që është për 0.2 pikë përqindje më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 40).

Grafik 40. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Norma e interesit për kreditë e ekonomitë familjare shënoi rritje për 0.1 pikë përqindje, në 21.8 përqind (grafik 40). Sipas kategorive të kredive, tek kreditë hipotekare, norma mesatare e interesit u rrit për 0.3 pikë përqindje në 19.6 përqind. Njëkohësisht, edhe për kreditë konsumuese, norma e interesit u rrit për 1.1 pikë përqindje, në 23.0 përqind.

Për korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua për 0.4 pikë përqindje, në

18.1 përqind. Sipas sektorëve ekonomik, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë e orientuara për sektorin e shërbimeve, pasuar nga kreditë për sektorin e bujqësisë me normë interesi 16.2 përqind dhe 19.4 përqind, respektivisht (grafik 41).

Grafik 41. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.


Norma e interesit për kreditë e shërbimeve shënoi rënie të theksuar prej 5.5 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Norma e interesit për kreditë ndaj sektorit të bujqësisë qëndroi kryesisht e pa ndryshuar, përderisa norma e interesit për kreditë ndaj sektorit të industrisë u rrit për 0.7 pikë përqindje (grafik 41).

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar muajin shtator 2021 e mbylli me fitim neto në vlerë prej 11.8 milionë euro kundrejt humbjes prej 2.7 milionë euro në shtator 2020. Ky fitim, ishte më i larti që nga konsolidimi i sektorit. Niveli i lartë i rezultatit financiar të sektorit u ndikua nga rikuperimi i ekonomisë vendore së bashku me rikuperimin e ekonomisë në nivel global si rezultat i lehtësimit të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Rikuperimi u përcoll me rritje

të konsiderueshme të kërkesës në vend si dhe në nivel global, si pasojë e investimeve të shtyra dhe rezervave të akumuluar për shkak të pasigurisë që solli kriza e pandemisë, veçanërisht gjatë vitit paraprak. Me rritjen e aktivitetit ekonomik dhe stabilizimin e ekonomisë, sektori zvogëloi konsiderueshëm provizionet për humbje nga kreditë, zë ky i cili u rrit në nivele të larta gjatë vitit 2020 si mbrojtje ndaj rrezikut të shtuar kreditor. Njëkohësisht, të hyrat e sektorit u rritën krahasuar me rënien që pësuan gjatë vitit paraprak. Të hyrat e sektorit deri në shtator 2021 shënuan vlerën prej 36.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.1 përqind. Rritja kryesisht i'u atribua rritjes së të hyrave nga jo-interesit, më saktësisht të hyrave tjera operative për 1.4 milionë euro (grafik 42). Përderisa, të hyrat nga interesi shënuan rritje vjetore marginale prej 0.7 përqind.

Grafik 42. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.


Shpenzimet e sektorit zbritën në 24.9 milionë euro nga 36.4 milionë euro sa ishin në shtator 2020, e që paraqet rënie vjetore prej 31.6 përqind. Rënia e shpenzimeve kryesisht reflekton uljen e shpenzimeve nga jo-interesi, saktësisht provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë. Njëkohësisht, shpenzimet nga

interesi shënuan rënie, ndërsa shpenzimet operative shënuan rritje.

Si rrjedhojë e përmirësimit të performancës së sektorit, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave shënoi përmirësim të dukshëm, duke u zvogëluar për 38.1 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke qëndruar në nivel prej 69.0 përqind në shtator 2021.

Performanca financiare e sektorit u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rritje të konsiderueshme në shtator 2021 në 4.6 përqind dhe 18.7 përqind, përkatësisht krahasuar me vlerat e ulëta në shtator 2020 (grafik 43).


Grafik 43. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Sa i përket treguesve të cilësisë së portfolios kreditore të institucioneve mikrofinanciare, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët, për më tepër patën edhe mbulueshmëri të lartë me provizione. Saktësisht, në shtator 2021 kreditë jo-performuese zbritën tutje në 2.9 përqind nga 3.2 përqind sa ishin në shtator 2020. Ndërsa,

mbulueshmëria e KJP-ve me provizione arriti në 136.6 përqind nga 134.6 përqind në shtator 2020 (grafik 44).


Grafik 44. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore



Tregu i letrave me vlerë

Deri në shtator 2021, Qeveria e Kosovës realizoi 16 ankande të emetimit të letrave me vlerë duke emetuar borxh në vlerë më të ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2020. Gjithashtu, kërkesa për investim në këto ankande tejkaloi ofertën për të njëjtat.


Grafik 45. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor



Borxhi i emetuar nga Qeveria e Kosovës deri në shtator 2021 shënoi rënie vjetore prej 5.3 përqind krahasuar me vitin paraprak, duke rezultuar në vlerën prej 286.2

milionë euro (grafik 45). Përderisa, nëse e krahasojmë emetimin e borxhit në periudhë tremujore, atëherë gjatë tremujorit të tretë, vlera e emetimit të letrave me vlerë tejkaloi vlerën e tremujorit të tretë në vitin 2020, duke shënuar rritje prej 19.1 përqind.

Grafik 46. Shuma e ofruar dhe emetuar




Burimi: Ministria e Financave.

Mungesa e tregjeve financiare në vend, si dhe mundësitë e kufizuara për investime alternative të mjeteve pasqyrohet në kërkesën për letra me vlerë të Qeverisë e cila vazhdimisht tejkalon ofertën përkatëse. Konkretisht, kërkesa për të investuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte për 1.60 herë më e lartë se sa shuma e ofruar. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM3 2021 ishte 2.1 përqind, normë më e ulët me atë të aplikuar gjatë TM3 2020 (grafik 46). Ngjashëm edhe nëse i krahasojmë normat e interesit në terma vjetore, norma mesatare e interesit e aplikuar deri në shtator 2021 ishte më e ulët se sa ajo

e aplikuar deri në shtator 2020. Rënia e normës së interesit krahasuar me periudhën paraprake u ndikua nga emetimi i një bono të thesarit me maturitet deri në 1 vit, instrument ky me normë të ulët të interesit e cila e ka ndikuar mesatarën e instrumenteve të emetuara deri në shtator 2021.

Struktura e letrave me vlerë dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare, me maturitet prej 3 vite, pasuar nga ato me maturitet prej 5 dhe 7 vite (grafik 47).

Grafik 47. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave.

Fondet pensionale, sektori bankar, institucionet publike dhe kompanitë e sigurimeve vazhdojnë të jenë institucionet investuese kryesore në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, ku sektori pensional vazhdon të jetë më i ekspozuari me 45 përqind të gjithsej stokut të borxhit të brendshëm.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2021): Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 36, TM3 2021, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK (2021):

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK (2021):

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-cmimeve-te-konsumit-ihck-qershor-2021>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-prodimit-icp-tm2-2021>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-importit-icimp-tm2-2021>
- d) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/repertori-statistikor-mbi-ndermarrjet-ekonomike-ne-kosove-tm2-2021>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-qershor-2021>

Të tjera (2021):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)

Bloomberg (2021): Metal Prices database: [Commodities - Bloomberg](https://www.bloomberg.com/professional/data/commodities/)

FAO (2021): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2021): Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2021): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](https://www.imf.org/)

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Shtator 2020	Shtator 2021
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	3,145.0	3,539.7
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.3%	2.3%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	-0.5%	4.9%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,215.2	1,611.2
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,418.8	1,464.5
Bilanci primar (në milionë euro)	-203.6	146.7
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,665.0	8,589.4
prej të cilave: Bankat	5,036.0	5,762.7
Kredi	3,182.5	3,572.0
Depozita	4,055.4	4,667.7
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.4%	5.9%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.5%	1.4%
Hendeku i normës së interesit	4.9%	4.5%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-315.6	-298.9
prej të cilave: remitencat e pranuar	697.0	861.4
Llogaria financiare	-376.7	-38.1
Investimet e huaj direkte në Kosovë	254.3	388.9
Investimet portfolio, net	-34.8	186.0
Investimet tjera, net	-141.1	-211.2
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-741.1	-960.0
Asetet	5,034.2	5,561.6
Detyrimet	5,775.3	6,521.6
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,259.4	2,690.7
Borxhi i jashtëm privat	1,740.7	2,030.0
Borxhi i jashtëm publik	518.6	660.7

Burimi:

1/ ASK (2021);

2/ MF (2021);

3/ BQK (2021).

*Të dhënat për BPV, PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në qershor 2021.

